



Fakulteti i Drejtësisë
Departamenti i të Drejtës Penale
Departamenti i të Drejtës Publike



Universiteti i Tiranës



Fakulteti i Shkencave Sociale

MASTER EKZEKUTIV NË KRIMINOLOGJI

Broshurë Informuese



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Masteri ekzekutiv në Kriminologji është hartuar për të përmirësuar kapacitetet e kërkimit për profesionistët, akademikët dhe politikëbërësit e drejtësisë penale të vendit, në parandalimin dhe luftën ndaj krimit, si dhe t'u përgjigjet nevojave të viktimave të krimit, në linjë me standardet e të Drejtave të Njeriut.

Kohëzgjatja e programit:

24 muaj (4 semestra), 120 kredite

Forma e studimit:

Me kohë të plotë

Gjuha e studimit:

Shqip, anglisht

Kriteret e pranimit:

- Diplomë “Master i shkencave”, ose ekuivalente me të;
- Studimet e larta të përfunduara në Drejtësi ose Shkenca Sociale, ose eksperiencë profesionale me ekspertizë në fushën e kriminologjisë;
- Njohje e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare.

OBJEKTIVAT

Masteri ekzekutiv në Kriminologji do të ndihmojë në krijimin e një grupi profesionistësh për të zbatuar metodat më të avancuara të studimit të kriminalitetit, për të shpjeguar kriminalitetin si dhe për të hartuar dhe zbatuar politika penale efikase.

Programi reflekton një perspektivë multidisiplinare për kualifikimin akademik të profesionistëve dhe ekspertëve të kriminologjisë duke rritur kapacitetet profesionale të burimeve njerëzore të institucioneve si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Gjykatat, Prokuroria, institucioneve përgjegjëse për ri-integrimin e viktimave të krimit, shërbimit të provës, autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e të miturve, si dhe çdo institucioni ligjzbatues, në lidhje me parandalimin dhe luftën ndaj kriminalitetit.

Ky Master është menduar t'i shërbejë studentëve që janë punonjës të praktikës dhe janë të angazhuar në hartimin dhe zbatimin e politikave penale për parandalimin e kriminalitetit dhe atyre që duan të vazhdojnë një karrierë në drejtësi, në fushën e kriminologjisë, me qëllim që të rrisin aftësitë e tyre në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit.

Master ekzekutiv:

Ligji 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”, në nenin 77 pika 2 ka përcaktuar se “Programet e studimeve “Master ekzekutiv” ofrojnë arsimim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional. Ato kanë kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike dhe organizohen përkatësisht me 60 ose 120 kredite. Ato përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma “Master ekzekutiv” në fushën e arsimimit të kryer”.

KOMPETENCA PROFESIONALE

Programi synon të plotësojë njohuritë dhe kompetencat e të gjithë të diplomuarve dhe profesionistëve në Kriminologji, si një shkencë moderne e një natyre multidisiplinare dhe ndërsektoriale.

Masteri ekzekutiv në Kriminologji ofron arsim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional duke:

- (a) zhvilluar njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si edhe përdorim të metodave të kërkim shkencor në fushën e Kriminologjisë;
- (b) thelluar njohuri të avancuara të kriminologjisë, hetimit, drejtësisë, psikologjisë, sociologjisë, e të tjerë;
- (c) fuqizuar studentët në njohjen dhe zgjidhjen e problemeve teknike dhe ligjore që paraqet krimi dhe dukuritë e kriminalitetit duke nxitur realizimin e kërkimeve specifike dhe ideve inovatore;
- (ç) aftësi të menduarit kritik dhe zhvillimin strategjik për të zgjeruar karrierën në fushën e kriminologjisë.

MUNDËSI PUNËSIMI

Sektorët në të cilët mund të punësohen të diplomuarit nga ky master janë të shumtë. Ata mund të angazhohen në pozicionin e specialistit, analistit, trajnerit, konsulentit, programuesit, drejtuesit të insititucionit e të tjerë, në insititucione si:

- a) Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme;
- b) Organet e qeverisjes vendore;
- c) Mekanizmat vendorë të referimit;
- d) Sektori i shërbimeve sociale në organet e vetqeverisjes;
- e) Policia e Shtetit;
- f) Sistemin e burgjeve;
- g) Shërbimin e provës;
- h) Shërbimet sociale në drejtësinë penale;
- i) Sistemin e drejtësisë, si Prokurori, Gjykatë;
- j) Organizata kombëtare dhe ndërkombëtare;
- k) Institucione akademike dhe të kërkimit shkencor.

1 Teoritë kriminologjike

Kjo lëndë fokusohet në studimin e teorive kriminologjike dhe ka për qëllim ta ekspozojë studentin ndaj hulumtimeve bashkëkohore dhe diskutimeve aktuale të teorive të krimit dhe deviancës, ku do të studiohen (i) teoritë që theksojnë faktorët individualë në shpjegimin e kriminalitetit nëpërmjet teorive biologjike e psikologjike, (ii) teoritë ekonomike të zgjedhjes racionale, (iii) teoritë sociologjike që theksojnë rëndësinë e faktorëve të grupit në shpjegimin e krimit duke përfshirë teoritë e shoqërimit të diferencuar, përkatësinë nënkulturore, etiketimin, demografinë, anominë dhe (iv) teoritë e konfliktit. Pjesa e fundit e studimit të lëndës i referohet rolit që kanë teoritë në hartimin e politikave penale. Në përfundim të lëndës, studenti njeh konceptet themelore të kriminologjisë duke iu referuar teorive kryesore.

2 Sistemet juridike bashkëkohore të drejtësisë penale

Lënda ka për qëllim të analizojë sistemet e drejtësisë penale të vendeve të ndryshme në raport me rolin e tyre për luftën dhe parandalimin e kriminalitetit në këndvështrimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër kriminalitetit. Metodologjia e këtij moduli do të jetë krahasuese, duke identifikuar anët pozitive dhe negative të çdo sistemi, atij shqiptar dhe të vendeve të tjera si Gjermania, Spanja, Italia, Holanda, Zvicra, Rusia, Kina, Japonia, e të tjerë. Konceptet themelore që do të trajtohen në këtë lëndë janë sistemi juridik, parandalimi i kriminalitetit, krahasimi i sistemeve dhe drejtësi penale.

3 Viktimologji

Viktimologjia synon të ofrojë dije në lidhje me viktimat e krimit, marrëdhëniet mes viktimës dhe autorit të veprës penale, studimeve të viktimave, nivelin e viktimizimit, faktorëve kriminogjenë,

që ndikojnë në nivelin e viktimizimit dhe parandalimin e viktimizimit në shoqëri. Në këtë modul, trajtohen standardet ndërkombëtare, evropiane dhe kombëtare lidhur me të drejtat e viktimave, trajtimin e tyre në sistemin e drejtësisë penale dhe jashtë tij. Lënda e pajis studentin me njohuri të thelluara shkencore në fushën e studimit dhe krahasimit të krimit nga këndvështrimi i viktimave, me pikëpamje teorike dhe praktike për studimin dhe ofrimin e trajtimit të viktimave në sistemin e drejtësisë penale, në përputhje me interesin më të mirë të viktimës. Moduli i aftëson studentët me shprehi për të dhënë një drejtësi të bazuar në normalizimin e marrëdhënieve mes viktimës dhe autorit.

4 Metodat e Kërkimit në Kriminologji

Në pjesën e parë, lënda do të merret me shpjegimin e metodave kërkimore cilësore dhe sasiore. Në këtë fazë të modulit do të mbulohen të gjitha fazat e kërkimit në fushën e kriminologjisë, nga planifikimi dhe hartimi i projektit, e deri te mbledhja e të dhënave dhe raportimi. Në pjesën e dytë të këtij moduli do të trajtohet studimi i aplikuar në kriminologji dhe puna me statistikat zyrtare (meta-analiza). Në këtë pjesë, studentët do të informohen rreth ndryshimit midis kërkimit shkencor të përgjithshëm dhe kërkimit shkencor për një rast specifik të aplikueshëm, që në kontekstin e këtij programi lidhet me kriminalitetin. Qëllimi i këtij kursi është t'i njohë studentët me metodat e kërkimit në kriminologji, duke dhënë përgjigje për mënyrën se si mund të ndërtohet një projekt kërkimor, ku dhe si mbledhen të dhënat, si interpretohen burimet zyrtare dhe statistikat, përse kanë rëndësi burimet zyrtare dhe statistikat, dhe si ndikon kërkimi në praktikën profesionale.

5 Metodikat Shkencore në Hetim

Kjo lëndë ka si qëllim të shohë metodat e hetimit nën një dimension të ri dhe të mundësojë një analizë të thelluar të koncepteve dhe parimeve menaxheriale. Gjithashtu, i ofron studentëve njohjen me një shkallë më të lartë të teknikave, taktikave dhe metodikave hetimore për të përcaktuar vendin dhe rolin e tyre në sistemin procedural,

përdorimin e tyre në ngjarje të rënda, dhe identifikimin, profilizimin e zbulimin e autorëve të veprave penale. Trajtimi i temave në auditor dhe praktikat mësimore do të konsistojnë në krijimin e vizionit se në çdo rast, në skenën e krimit duhet synuar në zbulimin e shpejtë të provave materiale, pyetjen e personave, që kanë dijeni për ngjarjen, si dhe krijimin e kushteve për një hetim të gjithanshëm dhe rritjen e efektivitetit të veprimeve hetimore.

6 Krimi i organizuar dhe Trafikimi

Kjo lëndë do të analizojë krimin e organizuar dhe trafikun e paligjshëm, duke përfshirë në program konceptet teorike të organizatës dhe aktivitetit kriminal, strukturat dhe modus operandi më të përdorshme, aftësitë, arsyet dhe impaktin që ka lidhja e krimit të organizuar me institucionet shtetërore dhe private në shoqëri. Lënda do të trajtojë edhe raste praktike nëpërmjet çështjeve studimore mbi krimin e organizuar shqiptar, mafian ballkanike dhe disa nga organizatat ndërkombëtare me shtrirje dhe aftësi ‘migratore’. Do të studiohen në mënyrë specifike format më tipike të trafikimit në Shqipëri, siç janë trafikimi i drogës, i armëve, si dhe trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i migrantëve. Lënda do t’i pajisë studentët me njohuri rreth politikave penale kundër krimit të organizuar, duke përfshirë këtu edhe rëndësinë e përfshirjes së shoqërisë civile dhe bashkëpunimin e saj me agjencitë ligjzbatuese.

Politikat penale në kriminologji

7 Kjo lëndë ofron njohuri në fushën e politikës penale në nivel global, evropian dhe kombëtar, lidhur me orientimet e jasme dhe të brendshme të politikës penale për parandalimin dhe adresimin e faktorëve që ndikojnë në format e veçanta të kriminalitetit në ditët tona. Në këtë lëndë do të trajtohen çështje të tilla, si: procesi i politikave, orientimet teorike ndaj kësaj politike, elementët rregullatorë si mjetet politike dhe tipologjitë e politikave, aspekte normative dhe çështjet empirike të politikës publike, roli i informacionit dhe vlerave në procesin e politikave; e të tjerë. Lënda do të qasë konceptualisht

studimin e krijimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave të drejtësisë penale. Në këtë lëndë do të analizohen standardet ndërkombëtare dhe evropiane të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikës penale për parandalimin dhe luftimin e veprave penale, të tilla si: krimi i organizuar, biomedicina, skllavëria moderne, krimet urbane, krimet e urrejtjes, krimet kompjuterike, radikalizmi dhe ekstremizmi, dhuna me bazë gjinore, si vepra penale, që përbëjnë kërcënime për sigurinë në nivel kombëtar dhe global, si dhe politika penale për trajtimin e grupeve të veçanta si: gratë, të miturit, minoritetet, të huajt, emigrantët si autorë dhe/ose viktima të krimit.

8 Lëndë me zgjedhje I

a. Etika, korrupsioni, media

Lënda do të studiojë standardet etike të veprimtarisë së organeve të drejtësisë dhe rëndësinë e komunikimit më publikun si mekanizëm përgjegjshmërie, llogaridhënieje dhe transparence. Në lëndë do të zbërthehen parime të akteve të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare në lidhje me standardet e përmbushjes së detyrave nga ana organeve të drejtësisë si dhe ato të komunikimit me publikun, duke përfshirë edhe jurisprudencën e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut. Lënda ofron një shqyrtim të thelluar të parimeve etike të organeve në sektorin e drejtësisë, rëndësinë e tyre për rritjen e besimit të publikut në rregullimin vendas dhe ndërkombëtar, me fokus të veçantë dilemat vendimmarrëse etike, me të cilat përballen zbatuesit e ligjit dhe profesionistët e drejtësisë penale. Në program do të analizohen format e korrupsionit në sistemin e drejtësisë në veçanti, e ngarkesa etike e ligjore përkatëse. Një vend i veçantë do t'i kushtohet praktikave më të mira të luftës kundër korrupsionit nga vetë institucionet, nëpërmjet zbatimit të kodeve të etikës dhe politikave kundër korrupsionit të ndërmarra nga ekzekutivi. Lënda shqyrton edhe ndërlidhjen mes krimit, drejtësisë penale, të drejtave të njeriut dhe medias me fokus reflektimin mbi rolin e medias në luftën kundër korrupsionit dhe rolin e saj në formësimin e opinionit publik, njëkohësisht, në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

b. Kriminaliteti i të miturve

Kjo lëndë do të trajtojë kriminalitetin e të miturve nga perspektiva të ndryshme psikologjike, sociologjike dhe fiziologjike. Vëmendje e veçantë i kushtohet rolit që variablat sociologjike dhe faktorët shoqërizues, si: familja, shkolla, bashkëmoshatarët, e të tjerë, luajnë në nxitjen ose parandalimin e kriminalitetit. Lënda ofron mundësi për të analizuar dhe vlerësuar politikat e drejtësisë për të mitur dhe programet e rehabilitimit. Lënda organizohet në disa seksione, si: natyra dhe përhapja e kriminalitetit të të miturit; teoritë e krimit; shkaqet e kriminalitetit të të miturit; kontrolli dhe parandalimi i tij. Studentët do të aftësohen në përcaktimin e kriminalitetit të të miturve nga perspektiva sociologjike dhe ligjore, si dhe do të krijojnë një tablo të kriminalitetit të të miturve në vendin tonë. Atyre do t'u jepet mundësia të hetojnë prirjet dhe vlerësojnë përhapjen e tij; të aplikojnë teoritë e krimit në kërkimin empirik për kriminalitetin e të miturve duke analizuar rolin që faktorët shoqërizues, kultura, diversiteti, shtresëzimi dhe pabarazitë sociale luajnë te sjellja kriminale; të analizojnë shkaqet e angazhimit të të miturve në sjellje kriminale; të njohin zhvillimet historike të kuadrit ligjor të drejtësisë për të mitur dhe të vlerësojnë efikasitetin e zbatimit të tij dhe rezultatet e arritura.

c. Organizimi dhe funksionimi i institucioneve në sistemin e drejtësisë

Kjo lëndë analizon organizimin institucional në sistemin e drejtësisë penale dhe ndërveprimin mes tyre. Lënda synon të analizojë tërësinë e institucioneve të sistemit të drejtësisë penale, si: policia, gjykatat dhe institucionet korrigjuese. Studentët do të shqyrtojnë se si këto institucione harmonizojnë sigurinë publike dhe interesat e komunitetit me të drejtat individuale. Ata do të shqyrtojnë vendimarrjen në këto institucione dhe analizojnë si këto vendime prekin shoqërinë dhe individët. Lënda synon të ofrojë njohuri themelore burimet e së drejtës për institucionet në sistemin e drejtësisë, parimet kryesore kushtetuese të organizimit dhe funksionimit të shtetit, organet e administratës publike dhe organizimin e funksionimin e organeve të krijuara me qëllim garantimin e drejtësisë

penale, juridiksionin dhe kompetencat e organeve, që operojnë në sistemin e drejtësisë, procedurën administrative dhe në përgjithësi procedurën e ndjekur nga këto organe, strukturën dhe organigramën e organeve të administratës publike dhe statusin e punonjësve të institucioneve, si dhe kontrollin e veprimtarisë së këtyre institucioneve.

d. Gjinia dhe Krimi

Në këtë kurs eksploroheh prerje sociologjike mes gjinisë dhe krimit. Do të shqyrtohen çështje si diferencat gjinore në kriminalitet, shpjegimet teorike për deviancën dhe krimin, për sulmet ndaj grave dhe vajzave, konstrukti social i krimit/sulmit, gratë dhe vajzat si viktime të dhunës dhe krimit në familje, seksualizimi dhe kriminalizimi i trupit femëror, përvojat femërore në burg dhe në sistemin e drejtësisë penale. Në këtë kurs do të studiohet teoria e kriminologjisë në lidhje me gjininë dhe do të shihet se si pabarazia gjinore ndikon në llojin e krimit, në dhunën në familje, përdhunimin, krimet ndaj grave, krimet ndaj burrave dhe krimet e grave dhe të burrave.

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njohë studentët me teoritë sociologjike të lidhura me gjininë, krimin dhe drejtësinë, në tre nivele: (i) Makro; (ii) Mezo dhe (iii) Mikro.

9

Lëndë me zgjedhje II

a. Drejtësia penale dhe të Drejtat e Njeriut

Kjo lëndë ka për qëllim të analizojë metodat dhe përmbajtjen e drejtësisë penale dhe të të drejtave të njeriut, jo vetëm në këndvështrimin normativ, por edhe mbi vendimet gjyqësore më domethënëse të juridiksioneve ndërkombëtare, apo të brendshme. Kjo qasje do të lejojë jo vetëm një reflektim mbi raportin e drejtësisë penale me të drejtat e njeriut, por edhe rolin qendror që ka praktika. Lënda synon të zhvillojë kuptimin mbi dokumentet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë jo vetëm të drejtat e autorit të veprës penale, por edhe të drejtën e viktimës në praktikën gjyqësore. Pas studimit të drejtësisë penale (ndërkombëtare dhe të brendshme) dhe të të drejtave

të njeriut, kjo lëndë do të evidentojë problematikat teknike dhe politike penale në lidhje me ndjekjen penale të krimeve të rënda, që çenojnë këto të drejta themelore. Në veçanti, lënda do të përqendrohet në zbatimin real të drejtësisë penale për procese, që janë zhvilluar në nivel kombëtar/ndërkombëtar, duke evidentuar qëndrimet për çështje të njëjta.

b. Terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm

Ky kurs ofron shpjegime teorike dhe empirike për shkaqet dhe natyrën e dhunshme të ekstremizmit politik. Në të ekzaminohen format kryesore të ekstremizmit përgjatë 100 viteve të fundit si: anarkizmi, fashizmi, komunizmi, gjenocidi dhe terrorizmi. Kursi shpjegon lidhjen mes këtyre formave të ndryshme të ekstremizmit politik. Në të analizohen shkaqet e përdorimit të dhunës për arritjen e qëllimeve politike si dhe përse disa ideologji çojnë në dhunë. Kursi shpjegon edhe ndryshimet mes formave të ekstremizmit të dhunshëm dhe shkallët që variojnë nga format e majta deri te ato ekstremisht të djathta, që çojnë në fashizëm. Në kurs shqyrtohet edhe procesi i radikalizimit, si parakusht për angazhim në aksione të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe lidhjet e religjionit fundamentalist me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin. Nëpërmjet lëndës, studentët do të mund të njohin shkaqet dhe natyrën e ekstremizmit të dhunshëm; do të kuptojnë rolin e faktorëve socio-politikë për ekstremizmin e dhunshëm dhe gjithashtu, do të kuptojnë shtysat drejt ekstremizmit, radikalizimit dhe terrorizmit.

c. Psikologji ligjore

Kjo lëndë merret me aplikimet empirike të psikologjisë në fushën juridike. Studentët do të aftësohen të merren konkretisht me çështje të tilla, si: cilësia e kujtesës së dëshmitarit okular, saktësia e dëshmisë, vendimarrja e trupave gjyquese, psikologjia e hetimit, drejtësia procedurale, kapaciteti për të përballuar gjyqin, të drejtat e të pandehurve, të viktimave, të fëmijëve dhe të personave me probleme të shëndetit mendor e të tjerë. Gjithashtu, lënda do të shqyrtojë lidhjen e shqetësimeve psikologjike me sjelljen devijante dhe kriminale, rolin që shëndeti mendor dhe çrregullimet e tij, si: skizofrenia, çrregullimet e personalitetit, dëmtimet e trurit dhe çrregullimet mendore, kanë në

sjelljen kriminale si dhe ndikimin që diagnozat e shëndetit mendor kanë te sjellja. Lënda do të fokusohet te metodat rehabilituese dhe efektiviteti i tyre në zgjidhjen e problemeve të shëndetit mendor në sistemin e drejtësisë. Psikologët ligjorë zotërojnë parimet sociale, kognitive e klinike dhe i zbatojnë ato në sistemin ligjor. Qëllimi i kursit është të ndihmojë studentët të zhvillojnë këndvështrime psikologjike për dukuritë juridike, duke mundësuar administrimin e një niveli më të avancuar drejtësie në çdo fazë të procesit.

d. Kriminologjia e gjelbër

Kriminologjia e gjelbër synon të trajtojë çështje të parandalimit të krimeve mjedisore, si: zbulimi, ndjekja penale dhe ndëshkimi/sanksionet, zhvillimi i krimit mjedisor në një aspekt kriminologjik dhe historik në Shqipëri. Në këtë lëndë do të trajtohen dispozitat, të cilat përcaktojnë përgjegjësinë penale për dëmtimin faktik dhe potencial ndaj mjedisit, format e shfaqjes së tij dhe mbrojtja juridiko-penale në nivel të brendshëm dhe në dokumenta ndërkombëtare, duke sjellë raste nga vendimarrja e gjyqësorit shqiptar. Fillimisht, vëmendja do të përqëndrohet te metododat më të rëndësishme, që përdoren për identifikimin, apo vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga krimi mjedisor, duke indentifikuar se cilat janë këto metoda dhe analizuar nëse kanë kufizime në teori dhe praktikë. Gjithashtu, në aspektin e ligjit material, do të trajtohen dispozitat, që përcaktojnë format e shfaqjes së cënimit ndaj mjedisit dhe përgjegjësinë penale për pasojat reale dhe potenciale ndaj mjedisit, si dhe mbrojtja juridiko-penale që ofron legjislacioni i brendshëm dhe ai ndërkombëtar.

10 **Praktika profesionale**

Praktika profesionale është një kurs formues, që synon të përgatisë studentët të ndërmarrin punë kërkimore në terren dhe të aplikojnë teorinë e kërkimit social përmes projekteve kërkimore empirike. Praktika profesionale organizohet kryesisht si punë terreni për mbledhjen e të dhënave, proces gjatë të cilit studentët mësohen të

përcaktojnë një pyetje kërkimore dhe ta testojnë atë përmes pyetësorit të anketës/ intervistës. Stadi i mbledhjes së të dhënave merr një rëndësi të veçantë në praktikën profesionale pasi është parakusht për mbledhjen e “lëndës së parë” për analizën sociologjike të një dukurie sociale. Më pas, studentët udhëhiqen në procesin e analizës së të dhënave dhe interpretimin e tyre bazuar te metodat analitike, që mesojnë gjatë kursit, si dhe te paketat e procesimit të të dhënave. Lënda synon të ndihmojë në njohjen e rolit të praktikës dhe në krijimin e shprehive profesionale si kriminologë.

11 Projekti kërkimor

Kjo lëndë ka si qëllim përgatitjen e studentit për të ndërmarrë një punim akademik kërkimor të pavarur, nën udhëheqjen e pedagogut përkatës. Në përfundim të studimeve, studentit do të kryejë një kërkim shkencor dhe për ta ndërmarrë atë duhet të hartojë një projekt kërkimor, i cili duhet të konsultohet dhe miratohet paraprakisht nga udhëheqësi. Kërkimi empirik, që do të ndërmerret nga studentit, synon të lidhë studimet teorike me praktikën dhe punën, që studentit do të zhvillojë në mënyrë të pavarur në terren. I gjithë informacioni dhe dija e fituar përgjatë studimeve do të duhet të materializohet nga ana e studentit në një formë të matshme dhe të vlerësueshme, në një punim shkencor, në formën e një mikroteze, që do të përmbahet projektit kërkimor të aprovuar nga departamenti.

12 Mikroteza

Mikroteza është punimi kërkimor që studentit kryen në mënyrë të pavarur nën udhëheqjen e pedagogut përkatës. Në mikrotezë, studentit sintetizon zbatimin e njohurive teorike të aplikuara në praktikën kërkimore, pasi ka kryer një studim në bazë të projektit kërkimor të aprovuar nga departamenti dhe pasi ka mbledhur të dhëna përgjatë praktikës profesionale, ose kërkimore në institucion, ose në terren. Në mikrotezë, studentit do të ndihmohet të zhvillojë të gjitha etapat e kërkimit shkencor në kapituj/pjesë, sipas standardit akademik për hartimin e diplomës, të pasqyruara edhe në rregulloren e punimit të diplomës.

Projekti *“Për krijimin e një programi masteri në kriminologji”* (2018-2021)
zbatohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri
dhe mbështetet financiarisht nga
Misioni i Shteteve të Bashkuara në OSBE

